

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E FINANCAVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në *Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave* me objekt: “Për mbikëqyrjen e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, për periudhën 1/1/2011 deri më 31/12/2011” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 81, datë 6/6/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 164/5, datë 6/6/2012 dërguar **Z. Ridvan Bode, Ministër i Financave**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Të planifikohet programi i angazhimit vjetor bazuar mbi risqet e identifikuar, por të bëhet kujdes me objektet që rezultojnë me tejkallim të afatit 2 vjeçar të auditimit, që në kushtet e heqjes së detyrimit lidhur me frekuencën e auditimit dhe ndryshimeve të reflektuara në manualin e ri të auditimit të brendshëm, të mos shndërrohen në një lloj risku të ri (*si risku i brendshëm dhe i kontrollit*)

Brenda muajit Nëntor 2012

2. Të bashkërendohen veprimet midis Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm për programimin e trajnimeve të detyruara për auditët mbi Manualin e ri dhe procesin e formimit profesional, përditësimin e njohurive dhe edukimin e përditësuar, pasi vërejmë se gjatë vitit 2011 nuk janë kryer trajnime të detyrueshme, që sipas normave të Manualit të Auditimit janë 50 orë në vit.

Gjatë vitit 2012

3. Të kryhen procedurat përkatëse të rekrutimit në shërbimin civil nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Financave për plotësimin e dy vendeve të lira të punës sipas organikës së aprovuar, me auditues publik të certifikuar, pasi edhe për vitin 2012 kapacitetet administrative vazhdojnë të jenë të pa mjaftueshme për të mbuluar me auditime cilësore objektet e juridiksionit të Ministrisë..

Brenda muajit Korrik 2012

4. Të ndiqet çdo 6 muaj, sipas një tematike të veçantë, zbatimi i rekomandimeve të Drejtorisë së Auditimit, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm Publik dhe Udhërrëfyesin për Auditimin e Sistemit Financiar.

Periodikisht

5. Të rritet eficensa e sistemit të instaluar mbi kontrollin e cilësisë, rishikimin dhe vlerësimin e dosjeve të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, me qëllim që procedurat e rishikimit të cilësisë të mos mbeten thjeshtë dokumente formal, por të shërbejnë si një filtër dhe si vlerë e shtuar organizative për përmirësimin e cilësisë së auditivit.

Vazhdimisht

6. Të përcaktohen me udhëzim të veçantë kriteret e përcaktimit dhe të përfshirjes në Planin Vjetor dhe Strategjik të objekteve, për të qartësuar përfshirjen ose jo të drejtorive të ministrisë herë si objekt analitik më vete, e herë si pjesë e objektit “Ministria”.

Brenda muajit Gusht 2012

7. Të përmirësohen procedurat e planifikimit dhe raportimit të auditimit, duke mbajtur parasysh pasqyrimin e ndryshimeve të planit dhe realizimit të tij (të shprehur në ditë-njerëz), mbështetur në eksperiencat e viteve të mëparshme dhe duke programuar numrin e auditimeve për zërin “ndjekje e zbatim rekomandimesh”.

Brenda muajit Tetor 2012

8. Të përmirësohen dhe rishikohen “Manuali i Auditimit të Brendshëm” dhe “Udhërrëfyesi mbi Auditimin e Sistemit Financiar Publik” me qëllim harmonizimi dhe unifikimi me kërkesat e Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale. Kjo kërkon unifikimin e nevojshëm të dokumentacionit bazë të auditimit ndërmjet strukturave të shërbimit të sigurisë si KLSH, Inspektimi Financiar Publik, Departamenti i Kontrollit Brendshëm Administrativ e Antikorrupsion dhe Auditimi i Brendshëm Publik, në kushtet e forcimit të luftës kundër korrupsionit, lidhur me dokumentimin e provave të nevojshme për ndjekjen e çështjeve që bëhen objekt i organeve kompetente, për rastet e shpërdorimeve financiare dhe mashtrimeve (si Procesverbal, Akt-verifikimi, etj.).

Brenda muajit Shtator 2012

9. Të vijojë ndjekja me rigorozitet e kthimit të përgjigjeve mbi zbatimin e rekomandimeve nga subjektet, pasi për 17 dosje auditimi, konstatohet se në 4 raste (Ministria e Integritetit, DASHPP, DD Kakavijë, DTH Librazhd), mungojnë përgjigjet ose nuk ka planveprimi sipas formatit standard nga subjekti; në 3 raste

(Shtypshkronja e Letrave me Vlerë, DTH Kavajë, DTH Librazhd), planveprimet e kthyera nga subjektet nuk kanë afate të përcaktuar sipas kërkesave të Manualit të Auditimit.

Brenda muajit Korrik 2012

10. Të evadohet materiali dhe dërgohen konkluzionet për dosjen e auditimit “Shtypshkronja e Letrave me Vlerë”, mbështetur në gjetjet e bazuara dhe të provuara (*me Vendimin nr. 873/ 3, datë 13.02.2012 të Agjencisë së Prokurimit Publik,*), sipas cilësimeve të paragrafit të fundit të këtij vendimi, që nënvizon se “*në lidhje me shkeljet e mësipërme të konstatuara, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të veprojë konformë legjislacionit penal e civil në fuqi*”.

Brenda muajit Gusht 2012

11. Të riverifikohen nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm çështjet që lidhen me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit justifikues ligjor për dosjen e auditimit “Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara” dhe të adresohet përgjegjësia në mënyrë përfundimtare, deri në zhdëmtimin e arkës së shtetit.

Brenda muajit Gusht 2012

12. Të përcaktohet referenca ligjore dhe struktura direkte zbatuese në formulimin e rekomandimeve dhe në planveprimin e sugjeruar për subjektet e audituara si p.sh (drejtoria, sektori, dega, zyra, personi përgjegjës, etj.), si dhe të referohet pasqyrimi i hollësishëm i këtyre çështjeve në raportin final.

Brenda muajit Korrik 2012

13. Të përmirësohet Udhëzimi mbi sistemin e planifikimit, evidentimit dhe raportimit të veprimtarisë audituese, me qëllim vlerësimin e performancës dhe krahasueshmërinë e të dhënave. Për këtë, Pasqyrat Anekse nr. 5 “Planifikimi nevojave të stafit për trajnime” dhe nr. 6 “Bilanci i burimeve njerëzore dhe kostoja e auditimit” që shoqërojnë Planin Vjetor dhe Strategjik (*sipas shkresës nr. 13580, date 01.07.2011 “Mbi procesin e raportimit periodik të strukturave të auditimit*), të përfshihen dhe si norma raportimi periodik.

Brenda muajit Korrik 2012

14. Të dorëzohen në arkivën e institucionit dosjet e auditimit të brendshëm për vitin 2011, pasi të jetë inventarizuar çdo informacion përbërës, sipas kërkesave të ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Qeram Cibaku Përgjegjës Grupi, Rajmond Koçi dhe Selfo Zeneli. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë zj. Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT